



**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë  
Prezenca në Shqipëri**

---

**Political and Public Affairs Unit**

**Zyra e Çështjeve Politike dhe Marrëdhënieve me Publikun**

**Deklaratë e Kryetarit të Prezencës,  
Ambasadorit Robert Bosch, para medias**

*15 dhjetor 2009*

**Pyetje: Kush po e thellon krizën: shumica që nuk po toleron apo opozita që nuk po futet në parlament?**

*Ambasadori Bosch:* Pikë së pari, do të doja të thosha se nuk mund t'i shtoj shumë asaj çka u tha tashmë nga ambasadori holandez, pasi ai ishte tepër i qartë e sepse ishin fjalë të thëna nga dikush që përfaqëson BE-në (unë nuk përfaqësoj BE-në) dhe sigurisht janë pikërisht ata që duhet të vendosin çfarë është mirë dhe çfarë nuk është mirë për ju për sa i përket *avis*. Por, thënë kjo, gjithçka ishte sigurisht mjaft e qartë.

Nuk e di nëse e lexuat fjalimin që mbajta javën e kaluar – veçanërisht shprehjen “duhen dy vetë për të vallëzuar”. Mund ta përsëris edhe një herë këtu, por para se ta bëj këtë, do të thosha se, që Shqipëria të ecë përpara, është shumë e rëndësishme që ajo të ruajë pavarësinë e institucioneve, që qeveria të mos ushtrojë presion mbi institucionet e pavarura dhe që ligji të bëjë punën e vet, gjatë gjithë kohës, pa pengesa. Kjo është shumë e rëndësishme për të ecur përpara.

Dhe ja ku dola tek ajo çka theksova javën e kaluar. Të gjithë ne, komuniteti ndërkombëtar, siç tha më herët edhe ambasadori holandez, u kemi kërkuar të dyja palëve që ta zbusin gjuhën e përdorur, të bëjnë një hap drejt njëri-tjetrit, por, deri tani, duket se askush nuk na e ka vënë shumë veshin. Prandaj, do të theksoja edhe një herë se duhen tri hapa bazë për të pasur një çift vallëzimi të qëndrueshëm. Mendoj se këto hapa duhet të varen në muret e çdo zyre, të qeverisë dhe të opozitës, si moto për kaq sa ka mbetur nga ky vit dhe për vitin e ardhshëm.

Edhe një herë:

***Hapi i parë*** – Duhet të komunikosh sistematikisht me partnerin apo partneren, përndryshe rrezikon t'i shkelësh këmbën – *prandaj, është koha për më shumë dialog!*

**Hapi i dytë** – Duhet t'ia vësh veshin me dashamirësi e ta ndihmosh tjetrin në pikat e dobëta – *prandaj, është koha për kompromis!*

Dhe, së fundi, **hapi i tretë**:

Çifti i vallëzimit nuk zgjat shumë, në qoftë se as nuk flet me partnerin apo partneren, në qoftë se as nuk i pëshpërit në vesh, ndoshta kësaj here në ato takimet jozyrtare që u përmendën më parë, pa praninë e medias, prandaj ka ardhur koha jo vetëm për të përdorur një gjuhë më të butë, por edhe për të folur me njëri-tjetrin me një ton normal.

Dhe këto fjalë bëhen sidomos edhe më të rëndësishme tani që po afrohen edhe Krishtlindjet, sepse kuptimi i Krishtlindjeve është që njerëzit të bëjnë një hap drejt njëri-tjetrit, ta duan njëri-tjetrin, dhe vërtet të përpiqen që ta bëjnë këtë botë më të mirë dhe jo duke përdorur gjuhë të ashpër, por duke përdorur një gjuhë të butë e duke u afruar drejt njëri-tjetrit. Prandaj shpresoj që kështu të kemi Krishtlindje shumë të lumtura. Gëzuar Krishtlindjet!

**Q: Sa i mundshëm mendoni se është kompromisi, sepse opozita nuk po shkon në parlament, madje po bën një lloj gare me shumicën se kush mund të mbledhë më shumë njerëz në shesh.**

*Ambasadori Bosch:* Prandaj i drejtohem secilës palë me fjalët 'flisni me njëri-tjetrin'. Kompromisi duhet të vijë gjithmonë nga të dyja palët dhe, siç e ka treguar historia anë e kënd botës, aty ku ka vullnet, ka edhe zgjidhje. Pra, siç thashë, mendoj se tashmë ka ardhur vërtet momenti që palët të bëjnë një hap drejt njëra-tjetrës.